



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 04

Prishtinë, më 13. 04. 2011, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzana Novoberdaliu – kryetare, Rita Hajzeraj - Beqaj, Ismet Beqiri, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Duda Balje dhe Kymete Bajraktari.

Mungoi: Justina. Sh. Pula.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi – OSBE, Lejla Selimi - OSBE, Natyra Kosumi NDI, Vesel Berisha - Sindikata e Pensionisteve, Muharrem Bajrami - Sindikata e Pensionisteve, Ramadan Ademi - kryetar i Sindikatës së Pensionisteve, Riza Shala - Sindikata e Pensionisteve, Xhemajl Ahmeti - OHCHR dhe Burim Tahiri, praktikant - Kuvendi i Kosovës.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi: Suzana Novoberdaliu - kryetare.

Suzana Novoberdaliu - Konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe e propozoi këtë

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve 29 dhe më 31 mars 2011,
3. Takim me Sindikatën e Pensionistëve dhe të Invalidëve të Punës të Kosovës ,
4. Caktimi i grupit të punës që do të merret me monitorimin e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje,
5. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve 29 dhe më 31 mars 2011

Rita Hazeraj - Kërkoj nga hartuesit e procesverbalit që më gjerësisht të përfshihen diskutimet.

Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të datës së 29. 3. 2011 dhe të 31. 03. 2011.

3. Takim me Sindikatën e Pensionistëve dhe të Invalidëve të Punës të Kosovës

Kryetarja – Tha se Komisioni ka njoftuar se kanë paraqitur petition qysh më herët. Njoftoi se janë të pakënaqur që nuk e kanë ligjin e tyre, si dhe me të ardhurat që i marrin. I kanë paraqitur kërkesat e tyre në petitionin dhe komisionet e mëhershme i kanë mbajtur dëgjimet publike. Kanë ardhur deri te rekomandimet, që i kanë dërguar në kryesi. Pyeti se a do t'i pranojnë veprimet e komisionit të kaluar apo do të kthehen prej fillimit.

Ismet Beqiri – Njoftoi se çështja e trajtimit të problemit të pensionistëve ka qenë edhe në mandatin e kaluar të Komisionit. Po ashtu njoftoi se ka pasur dëgjime publike, por edhe rekomandime, mirëpo nuk janë realizuar. Kërkesat e Komisionit, kur e ka udhëhequr zotëri Rexhepi, janë identike me ato që më herët i kanë bërë si komision. Kanë kërkuar që këto të futen edhe në buxhet, edhe në Ligjin për pensionistë, por nuk është bërë një gjë e tillë.

Kryetarja – Njoftoi se Komisioni në legjislaturën e kaluar i ka dërguar rekomandimet deri në Kryesi të Kuvendit që ajo t'i shtrojë për debat në njërin nga seancat plenare, por kjo nuk ka ndodhur.

Riza Shala - Falënderoi për nismën që është marrë. Po diskutoni për një shtresë që ka nevoja të mëdha, me një shtresë që është e anashkaluar. Nëse i krahasojmë pensionistët dhe invalidët e punës të Kosovës me pensionistët e tjerë të rajonit, sidomos me ato të ish-republikave të Jugosllavisë konstatojmë se ne jemi në pozitë më të pafavorshme dhe të diskriminuar. Të gjithë pensionistët kontributdhënës, deri para 3 vjetësh, janë krahasuar dhe janë paguar me të njëjtën mënyrë me të gjithë të moshuarit e tjerë. Draftligji që është duke u sjellë prej një sirtari në tjetrin, ju them me sinjeritet të plotë se është tërësisht i papranueshëm dhe nuk sjell asnjë pozitë më të favorshme.

Muharrem Bajrami - Sindikata e Pensionistëve - Të flasësh për këtë kategori të njerëzve është diçka shumë e rëndësishme, sepse kësaj kategorie i mungojnë gjërat elementare për të ekzistuar për të bërë jetë të dinjitetshme, njerëzore. Si përfaqësues të degëve në terren përpiqemi me tërë qenien tone njerëzore të bëjmë aq sa mundemi për ta ndihmuar këtë kategori të njerëzve dhe si komision do të ndërmarrim hapa të rëndësishëm për zgjidhjen e fatit të atyre që kanë nevoja shumë të mëdha.

Vesel Berisha - Ju falënderoj të gjithëve për këtë takim që është shumë i rëndësishëm. Ne jemi shtresa më e diskriminuar e shoqërisë jo vetëm në Kosovë, por edhe më gjerë. Kemi punuar dhe kemi krijuar pasuri për brezat e reja. Kemi ndërtuar edhe fabrika, por ato u shiten. Pyesim: Ku mbeten paratë? Ato u shiten pa u pyetur në fare. Ju lutem në emër të kësaj shtrese t'i paraqitni para njerëzve kompetentë kërkesat tona, sepse është momenti i fundit i durimit tonë. E dimë se ka mundësi të zgjidhet problemi i kësaj shtrese dhe të përmirësohen kushtet, por është duke munguar vullneti që kjo çështje të trajtohet.

Ramadan Ademi - Problemet tona janë të njohura. Historia e punëtorëve të Kombinatit Trepça është histori e dhimbshme. Mitrovica është një qytet i varfër. Nuk e ka më namin e dikurshëm. Kërkoj që ky problem të ngrihet në Kuvend dhe të vijë një përfaqësues i Sindikatës që të dëgjohet zëri ynë.

Rita Hajzeraj – Beqaj – I përshëndeti të pranishmit e Sindikatës së Pensionistëve. Tha se ata janë kategoria më e çmuar që duhet të ishin më të të respektuar në shoqëri. Problemi ka mbetur i papërfunduar në legjislaturën e kaluar. Secili nga ne e dimë situatën e rëndë në të cilën ndodheni. Janë disa sektorë që Qeveria nuk i ka prioritet për t'i zgjidhur problemet e tyre. Kot vjen ligji në Kuvend. Kot do të punojmë në këtë projektligj, kur nuk ka parë për t'u zbatuar. Ajo që ne mund ta bëjmë është ta sensibilizojmë këtë çështje dhe juve t'ju kthehen ato që keni kontribuar dhe i meritoni. Propozoj që komision parlamentar të kërkojë nga Kryesia e Kuvendit të lejojë debat parlamentar për këtë çështje. Jua rikujtojë kur të bëhet procedimi i P/ ligjit do të ftoheni në mbledhje të komisionit, në të cilën do të jenë të pranishëm përfaqësues nga Qeveria që për së afërmi të njoftohen me kërkesat tuaja. Pyeti: Kur e keni pasur takimin e fundit me Qeverinë e Republikës së Kosovës?

Kurtan Kajtazi - E njoftoi se sindikalistët kanë janë takuar me zëvendëskryeministrin dhe me ministrin e Financave. Tha se askush, madje asnjë subjekt politik nuk duhet të luajë me ndjenjat tuaja. Kërkesat tuaja duhet të jenë të përbashkëta, të të gjitha sindikatave, që të mos ketë dallime, sepse nesër mund të vijnë përfaqësuesit e një sindikate tjetër dhe të shtrojnë kërkesa të tjera. Kur të procedohet projektligji në Kuvend do ta japim kontributin, me qëllim që t'i mënjanojmë dobësitë në projektligj, ta ndryshojmë dhe ta rregullojmë sa më mirë që mundemi.

Albana Gashi - Vuri në pah në rekomandimet që i ka nxjerrë komisioni në legjislaturën e kaluar kemi gjetur vërejtje në pikat 2, 3 dhe 4. Vërejtjet për ndryshimin e këtyre pikave do t'i sjellim me shkrim.

Kryetarja - I falënderoi të ftuarit dhe kërkoi nga Komisioni t'i sjellë propozimet me shkrim dhe t'i paraqesë rekomandimet që t'i procedohen Kryesisë.

4. Caktimi i grupit të punës që do të merret me monitorimin e Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje

Komisioni lidhur me këtë pikë e nxori këtë

P e r f u n d i m

I. Formohet grupi i raportuesve në këtë përbërje:

1. *Albana Gashi, kryetare,*
2. *Duda Balje, anëtare,*
3. *Justina Sh. Pula, anëtare dhe*
4. *Sulltane Gashi, zyrtare ligjore, që do të ofrojë asistencë teknike për grupin e punës.*

II. Ngarkohet grupi i punës i raportuesve ta bëjë monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe t’ia paraqesë me shkrim raportin Komisionit.

5. Të ndryshme.

Kryetarja – I njoftoi anëtarët për disa takime që i ka pasur gjatë javës me Haki Kosumin, kryetar i asociacioneve të familjeve të personave të pagjetur, me bashkëdrejtuesin e zyrës së EULEXIT për mjekësi ligjore dhe me Prenk Xhetajn nga komisioni qeveritar për persona të pagjetur.

U vendos që takimi i radhës të mbahet më 27 prill dhe të shënohet edhe dita e personave të pagjetur.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzana Novoberdaliu